



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 1568/Prot.,
13

Datë 27/7/2023

VENDIM

Nr. 35 datë 26.07 2023

“Për miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programet e ciklit të tretë të studimeve, Master Ekzekutiv për vitin akademik 2023-2024”


Bazuar në ligjin nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, neni 3, pika 3, gërma ç; neni 38, pika 1, gërma a, pika 3; neni 98, pika 2, gërma c; neni 109, pika 1, gërma b; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 7, pika 3, gërma ç), neni 31, gërma u), si dhe në propozimin e Administratorit të UT-së, të mbështetur në propozimin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Institutit të Studimeve Evropiane-UT, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Tarifa e regjistrimit për programin e studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2023-2024, të jetë në shumën 5.000 lekë për ISE, dhe 3,000 lekë për Fakultetin e Drejtësisë
2. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë në programet e studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv” për vitin akademik 2023-2024, do të jetë sipas tabelave 1.4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët brenda kohëzgjatjes normale të programit të studimeve, i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit përkatës.
4. Studentët në programin e studimit të ciklit të tretë, “Master Ekzekutiv” me 120 kredite, paguajnë tarifë shkollimi për dy vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor). Studentët në programin e studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, me 60 kredite, paguajnë tarifë shkollimi për një vit akademik (sa kohëzgjatja e programit mësimor).
5. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës.

KRYETARI

PROF. DR. ARTAN HOXHA



UNIVERSITETI I TIRANËS**Tabela 1.4: TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE "MASTER EKZEKUTIV", PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

EMËRTIMI I FAKULTETIT/ FILIALIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Tarifa vjetore e shkollimit (në lekë)	
Fakulteti i Drejtësisë	Kriminologji	95,000	
Instituti i Studimeve Evropiane	EU Accession and Negotiations	100,000	